

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datë: 10.04.2013
Nr. 0204-360

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, Nr.01/011-3617, Pranuar me datë, 22.03.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/011-3617, të miratuar me datë 21.02.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.01/011-3617, për Lejimin e Shpalljes së Konkursit Publik për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurt të Pronës Komunale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datum: 10.04.2013
br. 0204-360

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine opštine Prizren

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Prizren , br.01/011-3617, primljeno dana ,
22.03.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br.01/011-3617, odobreno dana 21.02.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

Odluka br.01/011-3617, za dozvolu objavljivanja javnog konkursa o davanju na kratkoročno korišćenje opštinske imovine .

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 7. të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 12 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 21 shkurt 2013, morri këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E SHPALLJES SË KONKURSIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTË TË PRONËS KOMUNALE

Neni 1

Aprovohet propozimi i komisionit Komunal për Vlerësimin e Ofertave për dhënien e Pronës Komonale në Shfrytëzim, ashtu që lejohet shpallja e **konkursit publik** për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër e pjesëve të mbetura prej **7.000m²**, të ngast. Kadastrale nr. 127-3 dhe 127-5 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 22.879m², që evidentohen sipas Certifikatës nr.18-5854 dhe 18-584, si PSH KK Prizren.

Neni 2

Ngastrat e përshkruara si në nenin 1, (për pjesët e të cilave lejohet shpallja e konkursit publik dhe atë për sipërfaqen prej **7.000 (shtatë mijë) m²**), nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22.879 m², sipas Certifikatës nr. 18-5854 dhe 18-5854, të datës 12. 03. 2013, evidentohen si pasuri shoqërore KK Prizren.

Neni 3

Pronat në fjalë e përshkruar si në nenin 1 dhe 2, të këtij vendimi do të jepen në shfrytëzim me qëllim të largimit të deponisë së palejuar të krijuar nga qytetarët, rregullimit dhe mirëmbajtjesë krijimit të mjedisi shëndoshë për nxënësit e shkollës që gjendet në të njëjtat parcele, dhe përfitimit të mjeteve financiare për buxhetin e komunës.

Neni 4

Afati Kohor për dhënien në shfrytëzim me koncesion të pronës Komonale, do të jetë konformë nenit 3.1 të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nuk do të jetë më tepër se 15 (pesëmbëdhjetë) vite me të drejtë shkëputjes së kontratës edhe para afatit-deri, respektivisht deri në aprovimin e Planit rregullues për atë pjesë.

Neni 5

Konkursi publik do të shpallet në pajtim me ligjet që janë në fuqi, në mediet publike në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në territorin e komunës së Prizrenit dhe do të jetë e hapur së paku 30 ditë nga dita e shpalljes.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës Zyra e prokurimit dhe Shërbimi Pronëso-ro-juridik. Procedurat e mëtejme për dhënie në shfrytëzim të pronës sipas këtij vendimi do të vazhdojnë sipas procedurave të parapara me ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë dhe kopja e Planit i datës 12.03.2013 për sipërfaqet e cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori i Çështjeve Pronësore Juridike dhe Avokati Publik Komunal.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe do të shpallet në "Kumtar".


KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr: 01/011-3617

Më:21 shkurt 2013

Prizren



**Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu**